

Nr. ____ Prot.,

Tiranë, me 09.09.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje kite, reagente dhe materiale mjekësore ndihmëse në kuadër të Programit të Kontrollit Mjekësor Bazë”, i ndarë në lote:

LOTI 1: “Blerje kite-reagent për pajisje prodhues abbot/ose ekuivalent”.

LOTI 2: “Blerje kite-reagent për pajisje prodhues roche diagnostic/ose ekuivalent”.

LOTI 3: “Blerje kite-reagent për pajisje prodhues sysmex/ose ekuivalent”.

LOTI 4: “Blerje kite/testesh diagnostike për përcaktimin e gjakut okult (FOB).

LOTI 5: “Blerje materiale mjekësore për programin bazë”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Materiale mjekësore të konsumueshme- 33140000-3, Reagentë për laborator- 33696500-0.

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-99204-09-09-2026

LOTI 1: REF-99206-09-09-2026

LOTI 2: REF-99208-09-09-2026

LOTI 3: REF-99210-09-09-2026

LOTI 4: REF-99212-09-09-2026

LOTI 5: REF-99214-09-09-2026

Vlera e fondit limit: 1,635,852,309.34 (një miliard e gjashtëqind e tridhjetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntë pikë tridhjetë e katër) Lek pa TVSH ose 17,777,138.77 (shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH.

Vlerat ne Euro në këto dokumenta tenderi janë konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë 92.02 lekë, datë 9.9.2026.

LOTI 1 - “Blerje kite-reagent për pajisje prodhues ABBOT/ose ekuivalent” me fond limit: 433,217,126.67 (Katërqind e tridhjetë e tre milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH ose 4,707,858.36 (Katër milion e shtatëqind e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH;

LOTI 2 - “Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Roche Diagnostic/ose ekuivalent” me fond limit: 807,078,556 (Tetëqind e shtatë milion e shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH ose 8,770,686.33 (Tetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë tridhjetë e tre) Euro pa TVSH;

LOTI 3- “Blerje kite-reagent për pajisje prodhues Sysmex/ose ekuivalent” me fond limit: 87,358,066.67 (Tetëdhjetë e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lek pa TVSH ose 949,337.83 lekë (Nëntëqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e tre) Euro pa TVSH;

LOTI 4- “Blerje kite/testesh diagnostike për përcaktimin e gjakut okult (FOB) me fond limit: 127,312,500 (njëqind e njëzet e shate million e treqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Lek pa TVSH pse 1,383,530.75 (një million e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë pike shtatëdhjetë e pese) Euro pa TVSH;

LOTI 5- “Blerje materiale mjekësore për programin bazë” me fond limit: 180,886,060 (Njëqind e tetëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë) lek pa TVSH ose 1,965,725.49 (Një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë pikë dyzet e nëntë) Euro pa TVSH.

Vlerat ne Euro në këto dokumenta tenderi janë konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë 92.02 lekë, datë 9.9.2026.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, ”Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sha, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbështetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve që konkurohet/shumatores së loteve për të cilat konkurron.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” dhe pikën 1 të nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet

konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.... Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet se: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40 % e vlerës e fondit limit të lotit objekt prokurimi është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve që konkurohet/shumatores së loteve për të cilat konkurron**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar,

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben A.K. për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore**, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” i ndryshuar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM -së nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore," i ndryshuar, i cili përcakton kërkesat kryesore për vendosjen në treg të pajisjeve mjekësore, procesin e regjistrimit, vlerësimin e konformitetit, mënyrën e shpërndarjes, inspektimin dhe mbikëqyrjen e kësaj pajisje. Kërkesa përse i përket këtij autorizimi synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të sigurisë dhe shëndetit për pacientët, përdoruesit dhe palët e treta. Për autorizimin e tregtimit të pajisjeve mjekësore, kriteret e kualifikimit përfshijnë përputhjen me standardet e sigurisë dhe efektshmërisë të përcaktuara nga prodhuesi, si dhe respektimin e procedurave të regjistrimit dhe vlerësimit të konformitetit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **certifikate konformiteti CE** (ose deklaratë konformiteti DC), ose **certifikimin FDA** për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe pika 8 e nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor. Certifikatat e konformitetit CE (ose deklarata e konformitetit DC nëse është rasti) ose FDA approval janë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë përputhjen e produkteve me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Është e domosdoshme që furnizimet të jenë cilësore dhe konform rregullave të parashikuara nga aktet e BE (për konformitetin CE) ose të Shteteve të Bashkuara (Për aprovimin FDA). Ligjvënësit respektivë të këtyre rajoneve kanë parashikuar se materialet objekt prokurimi (sipas klasifikimit të riskut që kanë), t’i nënshtrohen një vlerësimi konformiteti rigoroz, nga palë të treta (OVK – organizma të vlerësimit të konformitetit), të akredituara, me qëllim që të përmbushin kriteret e cilësisë dhe sigurisë për përdorim tek pacienti fundor.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **ekuivalent** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për certifikimin ISO 13485:2016 "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore" ose ekuivalent, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e deklaratës. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, të dorëzojë certifikatën sipas deklaramentit të bërë.

Argumentimi: Keto kritere janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit me objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues konform specifikimeve teknike.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendndodhjen përkatëse të caktuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një deklaratë**, ku të deklarojë se afati i skadencës së mallrave objekt prokurimi, do të jetë sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë, nëpërmjet së cilës të konfirmojë se afati i skadencës së mallrave objekt prokurimi do të jetë në përputhje me kushtet e përcaktuara në specifikimet teknike, Shtojca 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, është vendosur me qëllim garantimin e cilësisë, sigurisë dhe përdorshmërisë së mallrave gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në momentin e furnizimit dhe të disponojnë një periudhë të mjaftueshme përdorimi, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i një afati minimal skadence është i nevojshëm për të shmangur furnizimin me produkte që kanë një afat të pamjaftueshëm përdorimi, duke marrë në konsideratë kohën e furnizimit, magazinimit, shpërndarjes dhe konsumit të tyre. Kjo ndikon drejtpërdrejt në administrimin e stokut, shmangien e skadimit të produkteve dhe garantimin e përdorimit të tyre në kushtet e përcaktuara nga prodhuesi.

Kërkesa është objektive, e lidhur me objektin e prokurimit dhe proporcionale me nevojën për të garantuar që mallrat e furnizuara të jenë të përshtatshme për përdorim dhe të përmbushin kërkesat teknike dhe të cilësisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastin e mallrave që përdoren në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, respektimi i afatit të skadencës merr rëndësi të veçantë, pasi lidhet me sigurinë e përdorimit të produktit, ruajtjen e karakteristikave të tij dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike :

SPECIFIKIMET TEKNIKE

LOTI 1: “BLERJE KITE-REAGENT PËR PAJISJE PRODHUES ABBOT/OSE EKUIVALENT”

Nr	Emërtimi i artikullit	Specifikime Teknike	Njësia
1	ARC CREATININE2 RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Metoda: Kinetik Alkaline Picrate, Te jete e pershtatshme per moster: Serum, plazme dhe urine. Te jete ne formatin reagent cartridge, Kapaciteti: min 400 teste/cartridge, Volumi R1 53.9 ml, Volumi R2 21.4 ml Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU. Afati minimal i skadencës në momentin e dorëzimit: ≥ 6 muaj	test
2	ARC ULTRA HDL RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Metoda: Accelerator Selective Detergent, Te jete e pershtatshme per moster: Serum, plazme. Te jete ne formatin reagent cartridge, Kapaciteti: min 360 teste/cartridge, Volumi R1 84 ml, Volumi R2 32 ml Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU. Afati minimal i skadencës në momentin e dorëzimit: ≥ 6 muaj	test
3	UREA NITROGEN2 KIT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Metoda :Urease/GLDH, kinetic. Te jete i pershtatshem per moster: serum, plazme ose/dhe urine sipas konfigurimit. Paketimi te jete 4 njesi per kit. Kapaciteti: min 350 teste/cartridge, Volumi R1 53.9 ml, Volumi R2 33.1 ml Afati i skadences te jete minimumi 6 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	test
4	ARC ALT2 (Alanine Aminotransferaze) RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Metoda NADH. Analiti: Alanine Aminotransferase (ALT/SGPT), Mostri: Serum dhe plazmë humane, Paketimi: 4×990 teste, Kapaciteti total: 3,960 teste/kit. Afati i skadences jo me pak se 6 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	test

5	ARC AST2 (Aspartate Aminotransferaze) RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Metoda NADH. Analiti: Alanine Aminotransferase (ALT/SGPT), Mostrat: Serum dhe plazmë humane, Paketimi: 4 × 990 teste, Kapaciteti total: 3,960 teste/kit. Afati i skadences jo me pak se 6 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	test
6	CC DIRECT BILIRUBIN RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Analiti: Bilirubina direkte (Direct Bilirubin / DBili),Paketimi: 2,000 teste/kit, Metoda: Diazonium salt, Mostra: Serum/plazmë humane, sipas aplikimit të prodhuesit, Skadencia te jete te pakten 6 muaj nga data e dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	test
7	ARC TTL BILIRUBIN2 RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Analiti: Bilirubinë totale, Metoda: Diazo colorimetric,Paketimi: 8 × 450 teste, Kapaciteti total: 3,600 teste/kit, Reagentët: R1 dhe R2., Volumi: R1 85.9 mL dhe R2 26.7 mL për një njësi të reagentit. Skadencia minimumi 6 muaj afat të mbetur në momentin e dorëzimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	test
8	ARC CHOLESTEROL 2 RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Metoda: Enzimatik kolorimetrike, Paketimi: 4 cartridge R1 62.5 ml, sipas konfigurimit të produktit, Skadencia te jete minimumi 6 muaj ne momentin e dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	test
9	ARC Cholesterol LDL RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Metoda Measured, Liquid Selective Detergent. Analiti: LDL-kolesterol (Low-Density Lipoprotein Cholesterol), Format: Reagent i lëngshëm me dy reagentë (R1 + R2).Paketim te jete minimumi 450 teste. Ruajtja: 2–8°C; të mos ngrihet, Skadencia te jete minimumi 6 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	test

10	ARC GLUCOSE RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale Metoda: Hexokinase/G-6-PDH, Paketimi: 5 cartridge R1 20 ml, sipas konfigurimit të produktit, Skadenca te jete minimumi 4 muaj ne momentin e dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	test
11	ARC TRIGLICERIDE2 RGT	Reagent / kit për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Metoda: Glycerol phosphate oxidase, Paketimi: 4 cartridge R1 90.5 ml, sipas konfigurimit të produktit, Skadenca te jete minimumi 6 muaj ne momentin e dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	test
12	MULTICHEM S PLUS LEVEL 1	Material kontrolli (QC) për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Material kontrolli i lengshem, i ngrire. Paketim 12x5 ml me volum total 60 ml/kit. Te mund te ruhet e pahapur per 30 muaj ne temperaturen -20 deri ne - 80 grade C. Te mund te ruhet e hapur per 7 dite ne temperaturen 2 deri ne 8 grade C. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Duhet te perfshije vlerat referente per testet biokimike (ALT, AST, Kolesterol, HDL, LDL, Trigliceride, Urea, Kreat, Glukoze, Bilirubin total dhe direkte, etj . Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.Të shoqërohet me Value/Assay Sheet përkatës. Skadenca te pakten 6 muaj	kuti
13	MULTICHEM S PLUS LEVEL 2	Material kontrolli (QC) për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Material kontrolli i lengshem, i ngrire. Paketim 12x5 ml me volum total 60 ml/kit. Te mund te ruhet e pahapur per 30 muaj ne temperaturen -20 deri ne - 80 grade C. Te mund te ruhet e hapur per 7 dite ne temperaturen 2 deri ne 8 grade C. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Duhet te perfshije vlerat referente per testet biokimike (ALT, AST, Kolesterol, HDL, LDL, Trigliceride, Urea, Kreat, Glukoze, Bilirubin total dhe direkte, etj . Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.Të shoqërohet me Value/Assay Sheet përkatës. Skadenca te pakten 6 muaj	kuti
14	MULTICHEM S PLUS LEVEL 3	Material kontrolli (QC) për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Material kontrolli i lengshem, i ngrire. Paketim 12x5 ml me volum total 60 ml/kit. Te mund te ruhet e pahapur per 30 muaj ne temperaturen -20 deri ne - 80 grade C. Te mund te ruhet e hapur per 7 dite ne temperaturen 2 deri ne 8 grade C. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Duhet te	kuti

		perfshije vlerat referente per testet biokimike (ALT, AST, Kolesterol, HDL, LDL, Trigliceride, Urea, Kreat, Glukoze, Bilirubin total dhe direkte, etj . Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.Të shoqërohet me Value/Assay Sheet përkatës. Skadenca te pakten 6 muaj	
15	ARC CONSOL CHEMISTRY CAL	Kalibrator për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Analitet e mbuluara : , ALT, AST, kolesterol, , kreatinin, bilirubinë totale, trigliceride, Urea Nitrogen.i destinuar për kalibrimin e metodave të kimisë klinike për substrakte dhe metabolitë. Kalibratori duhet të mbulojë parametrat përkatës të sistemit, të ketë vlera kalibrimi të përcaktuara sipas lotit dhe të shoqërohet me fletën e vlerave të kalibrimit. Paketimi: 12 × 5 mL, gjithsej 60 mL/kit, produkt IVD, origjinal, i pahapur. Skadenca te jete jo me pak se 6 muaj ne momentin e dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
16	CC MULTICONSTITUENT CAL	Kalibrator për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale për kalibrimin e analizave , Glucose, Paketimi: 2 x 3 × 5 mL – 3 vialë të nivelit 1 dhe 3 vialë të nivelit 2, Volumi total: 30 mL/kit. Skadenca te jete minimumi 6 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
17	CC BILIRUBIN CAL	Kalibrator për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale për kalibrimin e analizave , Direct Bilirubin, Paketimi: 2 x 3 × 5 mL – 3 vialë të nivelit 1 dhe 3 vialë të nivelit 2, Volumi total: 30 mL/kit. Skadenca te jete minimumi 3 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
18	RDX LIPID MULTICONST CAL	Kalibrator për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale për kalibrimin e analizave , LDL HDL, Paketimi: 6 × 1 mL, Volumi total: 6 mL/kit. Skadenca te jete minimumi 6 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti

19	ARC SAMPLE CUPS X 1000	Consumable / pjesë mbështetëse për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Tipi: Sample Cup, njëpërdorimëshe, Materiali: Plastikë e përshtatshme për përdorim laboratorik, Paketimi: 1,000 copë/kuti. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
20	DETERGENT A 2*500 ML	Material pastrimi / mirëmbajtjeje për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale Paketimi: 2 × 500 mL, Volumi total: 1,000 mL/kit”. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU. Skadenca te pakten 6 muaj	kuti
21	CC ACID WASH 2*500 ML	Material pastrimi / mirëmbajtjeje për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale ”. . Paketimi: 2 × 500 mL, Volumi total: 1,000 mL/kit. Skadenca te jete te mbi 6 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
22	CC ALKALINE WASH 2*500 ML	Material pastrimi / mirëmbajtjeje për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale ”. . Paketimi: 2 × 500 mL, Volumi total: 1,000 mL/kit. Skadenca te jete te mbi 6 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
23	DETERGENT B 2*400 ML	Material pastrimi / mirëmbajtjeje për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale Paketimi: 2 × 400 mL, Volumi total: 800 mL/kit”. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU. Skadenca te pakten 6 muaj	kuti
24	WATER BATH ADITIVE 2*500	Material pastrimi / mirëmbajtjeje për përdorim me Abbott ARCHITECT c8000. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale sipas zërit: “WATER BATH ADITIVE 2*500 ML(2)”. Paketimi: 2 × 500 mL, Volumi total: 1 L, Skadenca te jete te pakten 6 muaj ne momentin e dorezimit .Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti

25	CD RUBY 4000 DIL SHEATH 20L	Reagent diluent/sheath për analizatorin hematologjik Abbott CELL-DYN Ruby / CELL-DYN 4000, i destinuar për hollimin e mostrave dhe si solucion mbështetës/sheath gjatë procesit të numërimit hematologjik. Produkti duhet të jetë origjinal dhe plotësisht kompatibil me analizatorin CELL-DYN Ruby. Paketimi: 1 × 20 L (cubitainer). Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibil me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Skadenca minimumi 4 muaj afat të mbetur në momentin e dorëzimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
26	CD RUBY 3200 HGB NC LYSE 3.8L	Reagent HGB/NOC Lyse, pa cianid (cyanide-free), për analizatorët hematologjikë Abbott CELL-DYN Ruby / CELL-DYN 3200, i destinuar për lizimin e leukociteve WBC dhe për përcaktimin fotometrik të përqendrimit të hemoglobinës, si dhe për përgatitjen e segmentit për analizën NOC. Skadenca te jete minimumi 6 muaj nga momenti i dorëzimit .Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
27	CD RUBY WBC LYSE 3800ML	Reagent / diluent për përdorim me Abbott CELL-DYN Ruby. Reagent lizues për eritrocitet (RBC). Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibil me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Reagent i lëngshëm, ready-to-use. Forma: Reagent i lëngshëm, ready-to-use. Paketimi: 1 × 3.8 L, Enë: Cubitainer, Kapaciteti: 3,800 mL reagent për njësi. Skadenca te jete minimumi 6 muaj nga momenti i dorëzimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
28	ENZYMATIC CLEANER 2*50 ML	Material pastrimi / mirëmbajtjeje për përdorim me Abbott CELL-DYN Ruby. Pastrues enzimatik i lëngshëm, për përdorim laboratorik, Paketimi: 2 × 50 mL, Volumi total: 100 mL/kit. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibil me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale sipas zërit: “ENZYMATIC CLEANER 2*50 ML(2)”. Skadenca te jete minimumi 4 muaj nga momenti i dorëzimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti

29	CD 26 PLUS CONTROL	Material kontrolli (QC) për përdorim me Abbott CELL-DYN Ruby. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale .Kontrolli përmban 3 nivele kontrolli – Low, Normal dhe High – dhe përdoret për monitorimin e saktësisë dhe performancës së analizatorit dhe të parametrave të hemogramës. Produkti te jete me bazë gjaku human, i destinuar për kontrollin e cilësisë së analizave hematologjike dhe duhet të jetë plotësisht kompatibil me sistemin CELL-DYN përkatës. Paketimi: 12 x2.5 ml, me 2 flakonë për secilin nga 3 nivelet. Skadenca te jete jo me pak se 1,5 muaj nga momenti i dorezimit. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	kuti
----	--------------------	--	------

LOTI 2: “BLERJE KITE-REAGENT PËR PAJISJE PRODHUES ROCHE DIAGNOSTIC/OSE EKVIVALENT”

Nr	Emërtimi i artikullit	Specifikime Teknike	Njësia
1	Halogen Lamp Cobas c	Consumable / pjesë mbështetëse për përdorim ne pajisjet Cobas C Roche. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale .Tip : Halogen Lamp Assembly, Tension : 12 V, Fuqia: 50 W. Te kete te pakten 700 orë kohë pune të vazhdueshme ose 6 muaj përdorim (cilado te ndodh e para) .	copë
2	Cuvettes Cobas c (3)	Consumable / pjesë mbështetëse për përdorim ne pajisjet Cobas C Roche. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. me 24 segmente me kuveta. Kuvetat duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe në paketimin origjinal të prodhuesit, me lot/identifikim të produktit dhe të përdoren sipas kushteve dhe afatit të përdorimit të përcaktuar nga prodhuesi	Kuti x 24 segmente

3	PreciControl ClinChem Multi 2,20 x 5 mL Control(20)	Material kontrolli (QC) për përdorim ne pajisjet Cobas C Roche. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale ”. Analitetet te përfshijnë parametra të kimisë klinike si ALT, AST, ALP, amilazë, kolesterol, CK, kreatininë, LDH, lipazë, CRP, etj., Paketimi: 20 × 5 mL, gjithsej 100 mL/kit. Afati i skadencës së mbetur në momentin e dorëzimit: te kene jo me pak se 1/2 e afatit total te vlefshmerise se mbetur, por ne cdo rast, jo me pak se 6 muaj, pervec rasteve kur afati total i vlefshmerise i deklaruar nga prodhuesi eshte me i shkurter. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	ml
4	PreciControl ClinChem Multi 1,20 x 5 mL Control(20)	Material kontrolli (QC) për përdorim ne pajisjet Cobas C Roche. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Material kontrolli cilësor shumë parametrik PreciControl ClinChem Multi 1, Level 1, për monitorimin e saktësisë dhe precizionit të metodave kuantitative të kimisë klinike në analizatorët Roche cobas c.. Paketimi: 20 × 5 mL, gjithsej 100 mL/kit.Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU. Afati i skadencës së mbetur në momentin e dorëzimit: te kene jo me pak se 1/2 e afatit total te vlefshmerise se mbetur, por ne cdo rast, jo me pak se 6 muaj, pervec rasteve kur afati total i vlefshmerise i deklaruar nga prodhuesi eshte me i shkurter	ml
5	Detergent 1 NaOH-D Cobas c	Material pastrimi/mirëmbajtjeje për përdorim ne pajisjet Cobas C Roche. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Detergjent bazik me bazë NaOH, Paketimi: 66 mL /123 mL. Afati i skadencës së mbetur në momentin e dorëzimit: te kene jo me pak se 1/2 e afatit total te vlefshmerise se mbetur, por ne cdo rast, jo me pak se 6 muaj, pervec rasteve kur afati total i vlefshmerise i deklaruar nga prodhuesi eshte me i shkurter. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	ml

6	NaCl Diluent 9% Cobas c	Reagent/diluent për përdorim ne pajisjet Cobas C Roche. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Përqendrimi: 9%. Paketimi: 50/123 mL. Afati i skadencës së mbetur në momentin e dorëzimit: te kene jo me pak se 1/2 e afatit total te vlefshmerise se mbetur, por ne cdo rast, jo me pak se 6 muaj, pervec rasteve kur afati total i vlefshmerise i deklaruar nga prodhuesi eshte me i shkurter. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	ml
7	Eco-D (Ecotergent) Cobas c	Material pastrimi/mirëmbajtjeje për përdorim ne pajisjet Cobas C Roche. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Funkcioni: redukton rritjen bakteriale dhe formimin e flluskave, Paketimi: 12 × 59 mL / 1 x 123 mL, Volumi total: 708 / 123 mL, Shishja: Afati i skadencës së mbetur në momentin e dorëzimit: te kene jo me pak se 1/2 e afatit total te vlefshmerise se mbetur, por ne cdo rast, jo me pak se 6 muaj, pervec rasteve kur afati total i vlefshmerise i deklaruar nga prodhuesi eshte me i shkurter. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	ml
8	Cleaner Integra (Pastrues) Cobas c111	Material pastrimi / mirëmbajtjeje për përdorim me Roche Cobas Integra 400 / 400 Plus. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale . Volumi: 1,000 mL. Paketimi: 1 shishe × 1,000 mL . Afati i skadencës së mbetur në momentin e dorëzimit: te kene jo me pak se 1/2 e afatit total te vlefshmerise se mbetur, por ne cdo rast, jo me pak se 6 muaj, pervec rasteve kur afati total i vlefshmerise i deklaruar nga prodhuesi eshte me i shkurter. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	ml

9	Creatinine Jaffe Integra / Cobas c	Reagent/kit për përdorim ne pajisjet Cobas C Roche. Produkti duhet të jetë i përshtatshëm/kompatibël me platformën ekzistuese, me emërtim, paketim dhe karakteristika funksionale. Mostra: Serum, plazmë dhe urinë humane. Paketimi: Kit për 700 / 2500 teste . Afati i skadencës së mbetur në momentin e dorëzimit: te kene jo me pak se 1/2 e afatit total te vlefshmerise se mbetur, por ne cdo rast, jo me pak se 6 muaj, pervec rasteve kur afati total i vlefshmerise i deklaruar nga prodhuesi eshte me i shkurter. Të furnizohet me lot dhe afat skadence të identifikueshëm; kushtet e ruajtjes dhe përdorimit sipas IFU.	teste
